



Emri i institucionit:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Dokumenti Nr.:

RC/DS/117

Titulli:

Plani strategjik i biznesit për DPS/KT

Versioni:

01

Faqe Nr.:

Faqe 1/4

*PSB, 24.11.2021***Titulli i DPS/KT: DPS/KT 175****Trupa dhe lëndë druri e sharuar****Historiku**

KT 175 n[DPS është krijuar në 14.02.2003 në përputhje me rregulloren e brendshme të DPS duke ndjekur strategjinë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC mbi krijimin dhe funksionimin e komiteteve teknike. Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare në lidhje drurin dhe materialet t[p[rpunuara t[drurit.

1. Mjedisi i Biznesit i KT/DPS**1.1 Përshkrimi i mjedisit të biznesit**

Politikat e ndjekura, ekonomike, teknike, regullatore, ligjore dhe sociale përshkruajnë mjedisin e biznesit në sektorin industrial, atë të produkteve, materialeve, disiplinës ose praktikave që kanë të bëjnë me objektin e këtij KT dhe mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si drejtohen proceset e bërjes së standardeve, si dhe në përmbajtjen përfundimtare të standardeve.

Të gjitha produktet që janë subjekt i punës të KT 175 janë të bazuara në burimet pyjore. Pyjet kanë një funksion të rëndësishëm mjedisor dhe social përveç rolit të tyre si një burim i madh i lëndëve të para.

Tregu që mbulohet nga puna e këtij komiteti është:

- Druri i rumbullakët, i sharuar dhe i përpunuar,
- Materialet e sharuara dhe materialet e përpunuara lignified përveç drurit

që përdoren si p.sh. në mobileri, parket druri, veshjet me pllaka druri, paletat dhe paketimet... duke përjashtuar aspektet strukturore

1.2 Treguesit sasiorë të mjedisit të biznesit

Përmbledhja e më poshtëme mbi treguesit sasiorë përshkruan mjedisin e biznesit me qëllim që të japë një informacion të përshtatshëm për mbështetjen e punës të KT 129 në DPS.

Burimet pyjore ne Shqipëri

Lloji i pyjeve	Sipërfaqja në ha	Vëllimi në 10 ⁶ m ³
Pyjet e lartë	295.000	59.110
halor	85.000	15.710
fletor	210.000	43.400
Zabel(korije)	405.000	14.240



Emri i institucionit:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Dokumenti Nr.:

RC/DS/117

Titulli:

Plani strategjik i biznesit për DPS/KT

Versioni:

01

Faqe Nr.:

Faqe 2/4

shkure	242.000	0.200
Totali	942.000	73.550

Burimi (ANFI- inventari kombetar i pyjeve, i kryer nga Banka Boterore ne 2004)

Vëllimi i lëndës drusore (milion m³)

halorë	fletorë	shkurre	Totali
16.6	56.1	0.8	73.5

BURIMI: DPPK (2005)

Burimi (DPPK – Drejtoia e pergjithshme e pyjeve dhe kullotave)

Siperfaqja pyjore ne Shqiperi ze 52% te territorit te vendit. 58,7 milion m³ klasifikohen si lëndë punimi, ndërsa 14,9 milion m³ si dru zjarri. 70 % e siperfaqes pyjore administrohen nga pushteti lokal, vetem per nevojat e tyre (dru zjarri), pra nuk sherbejne si suport per zhvillimin e industries.

Lloji më i shfrytëzuar është ahë me një mesatare rreth 101000 m³/vit, referuar intervalit kohor 2000-2005, pasuar nga pisha e zezë dhe bredhi respektivisht me 14700 dhe 5700 m³/vit. Asortimentet që prodhohen janë kryesisht trupa sharre dhe dru zjarri.


Me poshte jepen te dhenat e FAO-s per vitin 2011.

Shfrytëzimi tregtar i pyjeve është ndërprerë për 10 vjet, qe nga viti 2005, por lihet hapur mundësia e prerjeve rralluese. Në këtë gjëndje ekonomia jonë pyjore për të paktën 10 vitet e ardhshme, nuk do të jetë e aftë për të dhënë një kontribut të konsiderueshëm në zhvillimin e industrisë përpunuese. Kjo për shkak të mundësive të kufizuara për prodhimin e lëndës drusore.

Sektori i përpunimit parësor të drurit përfaqësohet për momentin vetëm nga fabrikat e lëndës së sharruar. Në vitin 2009 operonin rreth 112 makineri për sharrimin e trupave. Për firmat e vogla kapaciteti mesatar i përpunimit është 1225 m³ trupa në vit dhe për ato të mesme është 6063 m³. Firmat e mesme punojnë mesatarisht 237 ditë në vit, kurse ato të vogla rreth 101 ditë. Produktet kryesore janë dërrasat 3, 5 dhe 7 cm trashësi. 54% e firmave të mesme dhe 8% të atyre të vogla kanë avancuar në prodhimin e elementeve, kryesisht për eksport. Pothuajse të gjithë eksportuesit janë të bindur se në të ardhmen e afërt do ta humbasin tregun. Pjesa më e madhe e firmave e shohin të zymtë të ardhmen e aktivitetit të tyre. Shkaku është mungesa e lëndës së parë.

Sektori i përpunimit dytësor të drurit përfaqësohet kryesisht nga fabrikat e prodhimit të mobiljeve, të dyerve dhe dritareve, të parketit dhe shkallëve. Aktualisht në sektorin e përpunimit dytesor operojne rreth 642 firma. Pjesa dërmuese e firmave janë të vogla dhe prodhojnë produkte vetëm për tregun lokal.

Firmat që përdorin lëndë të parë PZ dhe PF janë përqëndruar pranë zonave urbane dhe disa prej tyre janë çertifikuar sipas sistemit ISO. 92% e firmave punësojnë deri në 5 persona, 7% e tyre 6–20 të punësuar dhe 1% me mbi 20 të punësuar. 65% e firmave që punësojnë më shumë se 20 persona janë të lokalizuara në

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 3/4

Tiranë dhe Krujë. Sasia e konsumuar e lëndës së parë për më shumë se 70% e firmave nuk i kalon të 100 m³ në vit. Produktet kryesore të importuara janë PZ dhe PF. Dyert, dritaret dhe shkallët konsiderohen si produktet më të rëndësishme, të pasuara nga mobiljet shtëpiake dhe mobiljet e zyrave. 10% e firmave një pjesë të produkteve të tyre e eksportojnë. E ardhmja e këtij sektori duket optimiste.

2. PËRFITIMET E PRITËSHME NGA PUNA E KT/DPS

Standardet e kësaj fushe nevojiten për të lehtësuar tregtinë kombëtare, rajonale dhe botërore të produkteve të drurit. Ato ndihmojnë për:

- mënjanimin e mosmarveshjeve midis palëve duke përdorur një terminologji të përbashkët;
- mënjanimin e keq interpretimeve duke përdorur metoda të njëjta prove dhe marje mostre të njëjtë në vlerësimin e cilësisë së produktit;
- përdorimin e metodave të njëjtja matjeje për të evituar provat e dyfishta;
- të patur procedura të përbashkëta operacionale për të shmangur dallimet në kontrollimin e cilësisë së një produkti;
- të ndihmuar entet e specializuara kombëtare për hartimin e rregullave teknike në fushen që mbulon ky KT.

3 PJESMARJA NË KT/DPS

Të gjitha palët e interesuara në procesin e hartimit dhe të zbatimit të standardeve kanë të drejtë që të caktojnë ekspertët e tyre në KT të DPS si dhe në Grupet e Punes të ngritura për çështje të veçanta në mënyrë që të arihet një përfaqësim sa më e mirë i të gjithë palëve të interesuara.

4 OBJEKTIVAT E KT/DPS DHE STRATEGJITË PËR TË ARDHMEN

4.1 Objektivat e përcaktuara të KT/DPS

Bazuar në konsideratat e mësipërme si dhe në detyrimin që ka DPS për tu antarsuar me të drejta të plota në CEN, KT/DPS propozon objektivat dhe drejtimet strategjike për punën e saj të ardhshme:

- të sigurojë, për palët e interesuara, një platform të gjërë diskutimi mbi standardizimin e çdo fushe dhe sektori si dhe implementimin dhe zbatimin e standardeve evropiane;
- të adoptojë të gjitha standardet evropiane të të fushës së drurit;
- të rishikojë standardet puro shqiptare të drurit dhe të shfuqzojë ato standard që bien në kundërshtim me standardet evropiane EN;
- të mirmbajë dhe plotësojë databazin e DPS duke shtuar edhe qëllimin e standardit për të dhënë një informacion me të detajuar reth përmbajtjes së standardit.

4.2 Identifikimi i strategjive për aritjen e objektivave të KT/DPS

Përmbushja e objektivave të KT 175 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 38 Durability of wood and wood-based products
 CEN/TC 99 Wallcoverings
 CEN/TC 112 Wood-based panels

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT		Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 4/4

CEN/TC 124 Timber structures
 CEN/TC 142 Woodworking machines - Safety
 CEN/TC 175 Round and sawn timber
 CEN/TC 193 Adhesives
 CEN/TC 93 Ladders
 CEN/TC 171 Heat cost allocation
 CEN/TC 207 Furniture
 CEN/TC 364 High Chairs
 CEN/TC 398 Child Protective Products
 CEN/SS H99 Products for household and leisure use - Undetermined
 ISO/TC 162 Doors and windows
 ISO/TC 165 Timber structures
 ISO/TC 136 Furniture
 ISO/TC 51 Pallets for unit load method of materials handling
 ISO/TC 89 Wood-based panels
 ISO/TC 218 Timber

1. Planifikimi

Për realizimin e objektivave të mësipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve

2. Financimi

Kryetari dhe anëtarët e KT punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagese
 Sekretari i KT është punonjës i DPS

Sekretari i KT 175

(Pëllumb METOHU)